



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM

PËR

VEND TË LIRË PUNE NË POZICIONIN MAGAZINIER NË SEKTORIN E BURIMEVE
NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË DBNJ

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 67/2020, të Kuvendit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, Vendimit nr.202 të Këshillit të Ministrave, datë 15.03.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve shpall:

- 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin Magazinier në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Afati për dorëzimin e dokumentave: data 26.04.2022

Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

1. Të kryejë inventarizimin e materialeve, dokumentimin në magazinë hyrje, (marrjes në dorëzimin) apo daljes, (dorëzimit të materialeve, fletëhyrje, fletëdalje, proçesverbale) etj.
2. Të kryejë plotësimin e rregjistrimit të magazinës për çdo lëvizje hyrje dalje, dokumentet dhe kartelat përkatëse.
3. Të mbajë proçesverbale për çdo incident, thyerje, dëmtim apo shpërdorim.
4. Të mbajë inventarin e gjendjes së mallit në magazinë dhe të përgatitë raporte.
5. Të kryejë edhe detyra të tjera në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit.

Kërkesa të përgjithshme për kandidatët

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, që nuk është shuar sipas këtij ligji.
5. Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjisllacionit, në momentin e aplikimit;



Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

1. Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë, të nivelit bachelor në shkenca ekonomike.
2. Të ketë aftësi të mira komunikuese, bashkëpunuese, transparencë në punë.
3. Të jetë i disponueshëm të punojë jashtë orarit zyrtar të punës, në varësi të aktiviteteve.

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e protokollit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dokumentet e dosjes së tij personale:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje të jetëshkrimit;
3. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
4. Fotokopje e diplomës dhe listën e notave, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
5. Fotokopje e librezës së punës, nëse ka;
6. Fotokopje të kartës së identitetit;
7. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.

Lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë intervistën e strukturuar me gojë do të publikohet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KQZ-së.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në adresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr.4, Tiranë, si dhe të konsultoni faqen zyrtare në internet www.kqz.gov.al.

